



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. - 060/01-38700 dt. 09/09/ 2026

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Th ë r r e t

mbledhjen e **shtatë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **datë: 16.09.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 18.08.2026.
2. Propozim Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029.
3. Pyetje dhe përgjigje
4. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-37813 dt. 03/09/ 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.08.2026, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi (kryesues i Kuvendit), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) dhe Arbër Halilaj (BD).

Mungoi: Selman Çallapeku (PDKRLL).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci dhe drejtorët: Nexhmedin Gruda, Kaltrina Qerkinaj, Donika Prenku.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e dt.22.07.2026;
2. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit për periudhën 2026–2031;
3. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit;
4. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit;
5. Raport rreth korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2026;
6. Pyetje dhe përgjigje;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës me dy pika shtesë.

1. Propozim-vendim për financimin e projektit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”.

2. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesës së parcelës 381-1 ZK.Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim këtë rend dite. Të pranishëm ishin 6 anëtarë. Ky rend dite rekomandohet për Kuvend. Për votuan 6, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e parë: **(1) Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 22.07.2026.** Meqenëse diskutime nuk pati, pika e parë e rendit të ditës kaloi. Për votuan 6, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dytë: **(2) Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit për periudhën 2026–2031.**

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda theksoi se, ne e kemi paraqitur si draft, besoj që edhe ju jeni pajisur me material me kohë. Ne propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë për Kuvend dhe si draft të aprovohet. Për çdo paqartësi jemi këtu për t'ju sqaruar.

Pajtime Berisha theksoi se, dëshironte të dinte nëse do të ketë linjë të autobusit për fshatin Vasilevë dhe Poklek i Vjetër, sepse vetëm ai fshat ka mbetur në Komunën e Drenasit që nuk ka transport.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, tha se edhe në draft-plan është biseduar për këtë çështje dhe janë duke u shikuar mundësitë buxhetore për subvencionimin e këtyre linjave.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, iu drejtua drejtorit Gruda, duke thënë se, së pari duhet të vendosen kriteret për operatorët e linjave të autobusëve. Kush dëshiron të operojë me ato linja që u janë përcaktuar kriteret paraprakisht – mirë, kush nuk dëshiron – në rregull. Ai shtoi se nuk duhet t'i subvencionojnë, sepse nuk ka buxhet për subvencionim.

Pajtime Berisha, kërkoi që të paktën të përshtatet orari për nxënësit, sepse ata detyrohen të vinë në këmbë çdo ditë gjatë gjithë vitit. Ajo shtoi se jo të gjithë prindërit i kanë mundësitë financiare për t'i sjellë fëmijët në shkollë.

Egzona Tërdevci tha se, një çështje që e ka shqetësuar gjithmonë është mungesa e transportit pasdite, sepse në Drenas të gjitha linjat përfundojnë në orën 18:00. Ajo pyeti nëse do të kishte mundësi, qoftë me rregullore apo me plan, që t'u bëhet kërkesë operatorëve për të mbajtur edhe një linjë më vonë për njerëzit që punojnë. Për shembull, të ketë një linjë në orën 20:00, qoftë edhe me kapacitet më të vogël si kombibus.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, pyeti nëse kjo kërkesë vlente për të gjitha linjat apo vetëm për ndonjërin prej tyre, duke shtuar se gjatë përpilimit të rregullores mund ta kenë parasysh këtë kërkesë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, theksoi se problemi qëndron të financat, pasi autobusët nuk kanë mundësi të operojnë në orare të caktuara për vetëm një apo dy udhëtarë. Ai sqaroi se kombibusët janë të ndaluar me ligj që të veprojnë. Lidhur me këtë temë, ai iu drejtua Egzonës, duke pasur parasysh që ajo punon në ministri dhe i kërkoi ndihmë pasi ministria ka ndërtuar rrethin rrotullues të stacioni, por askund nuk ka vend ku të vendoset tabela dhe të ndalet autobusi i Skënderajt. Ai tha se aty kemi dy dëme: së pari, po krijohen kolona dhe së dyti, operatorët nuk po hyjnë brenda stacionit për të paguar tarifën, gjë që po shkakton mungesë buxheti për t'i paguar punëtorët. Në fund, ai shtoi se rregullorja për linjat është duke u hartuar dhe do të bëhet ashtu siç vendosin anëtarët, kurse mundësitë e operatorëve mbeten temë e tyre, duke siguruar se nuk ka asnjë interes personal në këtë mes.

Egzona Tërdevci tha se, e kupton pjesën e ngarkesës buxhetore, por e dha si opsion sepse do t'ua lehtësonte shumë jetën njerëzve që punojnë në orët e vona, e sidomos vajzave. Lidhur me pjesën e vendndaljes së gabuar të stacioni i autobusëve, ajo theksoi se këtë shqetësim e kanë nga të gjitha komunat, prandaj do të shikojë se si është situata për të gjetur një zgjidhje.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, shtoi se kanë kërkesa edhe për parkun e biznesit që punëtorët të kenë një linjë transporti. Ai propozoi që të shkohet e të bëhet një dëgjim publik atje për të parë nevojat e tyre dhe nëse ekziston mundësia të organizohet transporti deri në parkun e biznesit, të paktën për ndërrimin e parë.

Pas diskutimeve, **Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi,** hodhi në votim pikën e dytë: **(2) Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Gllgocit për periudhën 2026–2031.** Për votuan 6, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë: **(3) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit.** Pasi nuk pati diskutime edhe kjo pikë u rekomandua për Kuvend. Për votuan 6, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt: **(4) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit.**

Egzona Tërdevci tha se, në seancën e kaluar kryetari ka thënë që nëse bëhet ndryshimi i statutit, ndryshon edhe çështja e emrit dhe në dokumente do t'i referohen vetëm si Gllogoc, nëse e ka kuptuar drejt. Ajo kërkoi të dinte se si do të mbetet kjo çështje.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, tha se, Drenasi emrin kushtetues e ka Gllogoc dhe në çdo dokument zyrtar janë të detyruar t'i referohen si Gllogoc, ashtu siç u referohet edhe MAPL-ja. Ai përmendi se më herët kishin formuar një komision, ku pjesë kishte qenë Arbëri dhe kryesuese Shqipe Zogu, por ai nuk kishte funksionuar. Ai sqaroi se nëse e ndërrojnë komplet statutin, ekziston rreziku që MAPL-ja ta kthejë mbrapsht në Kuvend për të vazhduar me vulën aktuale, gjë që sipas tij është jokushtetuese. Ai shtoi se duhet të bëhet propozim-ndryshimi i disa amandamenteve për të mos pasur telashe, duke theksuar se në Kushtetutë janë të përfshirë me emrin Gllogoc dhe se ndryshimi i emrave të qyteteve, fshatrave dhe lokaliteteve duhet të bëhet me kushtetutë

Arbër Halilaj tha se, me gjithë këto pengesa, është pro hartimit të një drafti dhe amandamentimit, pasi statuti aktual është i mangët që nga viti 2008 dhe gjërat kanë ndryshuar e duhet plotësuar. Sa i përket çështjes së emrit, ai e cilësoi si emër diskreditues dhe që bart në vete aspektin historik, ndonëse zyrtarisht përdoret si Gllogoc. Nga ana tjetër, ai përmendi se Ligji për Kufijtë Administrativë të Komunave thotë që gjashtë muaj pas regjistrimit të popullsisë ka të drejtë të ndryshohen kufijtë, bashkimi i komunave ose ndryshimi i emërimit, mirëpo këtë nuk e ka iniciuar askush. Ai shtoi se do të provojnë të bëjnë diçka, me shpresën që ministria mos t'i kthejë në pikën zero.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e katërt: **(4) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Drenasit**. Për votuan 5, abstenime 0, kundër 1.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë: **(5) Raport rreth korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2026**.

Drejtoresha e Bujqësisë, Donika Prenku raportoi se, gjatë këtij viti në Komunën e Drenasit gjithsej kanë qenë të mbjellë 3 mijë e 235 hektarë. Prej tyre, 2 mijë e 970 kanë qenë të mbjellë me grurë. Rendimenti mesatar ka qenë 5 mijë e 100 kg/ha, d.m.th. ka qenë më i mirë se vitet e kaluara. Për këtë gjë kanë ndikuar kushtet atmosferike. Kanë qenë disa pengesa sepse ka qenë një numër i vogël i pikave grumbulluese në Komunën e Drenasit dhe disa fermerë e kanë dorëzuar grurin edhe jashtë Drenasit, duke rritur koston e transportit dhe të dorëzimit. Komisioni ka dalë me një rekomandim që kjo të përmirësohet gjatë vitit në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi tha se, meqenëse ky është vetëm raport dhe nuk votohet, vazhdojmë me pikën e gjashtë: **(6) Propozim-vendim për financim të projektit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara 'HANDIKOS'**.

Drejtoresha e Shëndetësisë, Kaltrina Qerkinaj tha se, ne kemi kërkuar shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike. Gjithsej kanë qenë vetëm dy OJQ që kanë aplikuar. Shuma për këtë thirrje ka qenë gjithsej 5000 euro.

'HANDIKOS'-i i ka plotësuar të gjitha kriteret, gjithçka ka shkuar në rregull, tani ka mbetur vetëm të miratohet në kuvend.

Egzona Tërdevci, ngriti dy çështje e para, nëse ka hapësirë financiare për ta rritur buxhetin për këtë mbështetje, dhe e dytë, nëse ka mundësi të bëhet një zgjidhje për çështjen e objektit. Ajo theksoi se 'HANDIKOS'-i bën një punë shumë të mirë, por nuk i ka kushtet minimale për ushtrimin e fushëveprimtarisë së tyre.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, sa i përket subvencionimit nuk kemi mundësi, na i kanë marrë edhe mjetet e shërbimeve publike të dritave e krejt. Sa i përket mundësive me e ndërtu një qendër, janë në disa vende, jemi duke parë mundësitë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e gjashtë: **(6) Propozim-Vendim për financim të projektit të Shoqatës së personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”**. Për votuan 6, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën: **(7) Propozim-Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.**

Egzona Tërdevci tha se, në parim nuk jam asgjë kundër për me ndarë çfarëdo prone për Qendrën për Punë Sociale, por mendoj që janë dy lokacione më të përshtatshme se sa kjo, edhe më në qendër. Është vendi ku është aktualisht, nuk e di pse mos me qenë prapë aty ku është, edhe është vendi ku i kemi marrë këto shtëpitë e vogla, këto më duken vende më të përshtatshme.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, të gjitha institucionet e nivelit lokal janë në këtë hapësirë, secila është kërkesë e përgjegjësit të Qendrës për Punë Sociale. Po e dërgojmë në Kuvend për me shpall interes të përgjithshëm pronën tonë të komunës, e cila e ka edhe një objekt që mundet me u përdor, edhe mos me shpenzu ne për me bërë objekt të ri.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e shtatë: **(7) Propozim-Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.** Për votuan 3, abstenime 2, kundër 1.

Egzona Tërdevci tha se, jemi në kulmin e temperaturave të nxehta dhe ka 3 javë që nuk i kanë marrë mbeturinat, besoj e ke parë zgjidhjen që e ka bërë Obiliqi, a mundemi me vepruar edhe ne njëjtë me e zgjidhur këtë problem.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, tha se Obiliqi e ka bërë një zgjidhje, ka marrë vendim me blerë kamionë, i ka 6 milionë euro të hyra prej KEK-ut, ne nuk kemi ato mundësi. Kryetari i Podujevës na ka ftuar në një takim për këtë qëllim, po presim me e mbajtur. E vetmja gjë që mundemi me bërë është me paditë kryeshefin për rrezik të shëndetit publik. Fushë-Kosova ka marrë kompani private ku ia paguan një shofer edhe kamionin për ton të mbeturinave, i ka punëtorët e kompanisë, naftën, edhe unë jam i gatshëm me e bërë të njëjtën gjë dhe me i paguar 25 euro për ton si komunë. Por, problemi është derisa ta shkëpusim inkasimin edhe niveli qendror duhet të na e lejojë atë gjë. Ne kompaninë "Eko Drenasi" nuk mundemi me e regjistruar, si fushë e veprimtimit është bartja e mbeturinave, se nuk na e regjistron MAPL-ja. Të shohim a po mundemi me bërë buxhet deri në fund të muajit edhe me parë mundësitë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 10:53.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi